Arsimi i Mesëm për Nxënësit e Komunitetit Rom dhe Egjiptian

STUDIM — ROMA VERSITAS ALBANIA | PROJEKTI RARE, FAZA II

Ky studim u realizua nga **Roma Versitas Albania** në kuadër të Projektit **"Veprimi Rajonal i BE-së për Arsimin e Romëve: Rritja e Mbështetjes Arsimore dhe Mundësive për Studentët Romë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (RARE)"**, faza II, i financuar nga Komisioni Europian nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore dhe i zbatuar nga REF Rumania dhe REF Serbia.

Mendimet e shprehura në këtë studim janë përgjegjësi e autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërish politikën dhe mendimet e organizatës Roma Versitas Albania. Versioni origjinal në gjuhën shqipe është burimi parësor.

Hyrije: Pabarazimet Arsimore të Komunitetit Rom dhe Egjiptian

Sfidat kryesore

- Numri i nxënësve Romë dhe Egjiptianë që ndjekin sistemin arsimor po shënon rënie nga viti në vit
- Pjesëmarrja është ndjeshëm më e ulët kur krahasohet arsimi fillor me atë të mesëm apo të lartë
- Ekziston pabarazi gjinore e theksuar brenda këtyre komuniteteve
- 45.28% e punëkërkuesve Romë të papunë nuk kanë përfunduar arsimin fillor


Konteksti i gjerë

Sipas Anketës së Forcave të Punës (LFS) të vitit 2021, **41.6%** e forcave të punës dhe **48.3%** e popullsisë në moshë pune në Shqipëri është me arsim bazë (8/9-vjeçar) ose më të ulët.

Shqipëria përballet me dy sfida kryesore: nivelin e ulët të aftësive të popullsisë në moshë pune dhe mungesën e aftësive të kërkuara në tregun e punës.

Adresimi i kësaj pabarazie është thelbësor për nxitjen e përfshirjes sociale, reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e perspektivës së punësimit në afatgjatë.

Metodologjia e Studimit



Analiza Cilësore

Analiza Sasiore

Konkluzione & Rekomandime

Studimi bazohet në kombinimin e dy metodave kryesore: **analizës cilësore** (kuadri ligjor kombëtar, standardet ndërkombëtare, jurisprudencë e GjEDNj-së) dhe **analizës sasiore** (dy pyetësorë të zhvilluar në Maj 2025). Nga kërkesat zyrtare për informacion, vetëm AKPA iu përgjigj brenda afateve ligjore. MAS dhe MSHMS nuk dhanë përgjigje përfundimtare.

98

Pyetësorë nxënësish

18 pyetje (15 të mbyllura, 3 të hapura)

108

Pyetësorë prindërish

15 pyetje (14 të mbyllura, 1 të hapur)

3

Institucione të kontaktuar

MAS, MSHMS dhe AKPA

1

Institucion i përgjigjur

Vetëm AKPA u përgjigj brenda afateve ligjore

Aktet Ndërkombëtare dhe Standardet për AFP

Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP) është procesi i të mësuarit të aftësive profesionale dhe teknike të nevojshme për punësim. Për komunitetin rom, AFP ka rëndësi strategjike për integrimin në tregun e punës, zhvillimin e aftësive tradicionale, luftimin e diskriminimit dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjeve.



Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 14 ndalon diskriminimin. Protokolli nr. 12 sanksionon ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. Neni 2 i Protokollit nr. 1 garanton të drejtën për arsim.



PNDESK — Nenet 6, 7, 13

Garanton të drejtën për arsim dhe punë, përfshirë AFP, pa diskriminim. Komentet nr. 13 dhe nr. 18 krijojnë Kornizën 4A: disponueshmëri, aksesueshmëri, pranueshmëri, përshtatshmëri.



UNESCO — Konventa 1960 & SDG4

Instrumenti i parë ndërkombëtar detyrues që ndalon çdo formë diskriminimi në arsim. "Education 2030/SDG4" thekson aftësitë bazë, kompetencat digjitale dhe mësimin gjatë gjithë jetës.



ILO — Konventa Nr. 142 (1975)

Detyron shtetet të zhvillojnë politika gjithëpërfshirëse të zhvillimit të burimeve njerëzore, duke lidhur orientimin dhe trajnimin me kërkesën e tregut të punës.

Standardet e Këshillit të Evropës për AFP

Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh që vendosin standarde konkrete për përfshirjen e romëve në arsim dhe trajnim profesional, duke evoluar nga integrimi kulturor tek fuqizimi aktiv i të rinjve.

2005 — Korniza Referuese

Programet e AFP-së duhet të përfshijnë elemente të kulturës rom, duke njohur zyrtarisht zanatet tradicionale dhe duke i integruar ato në kurrikulë.

RFCDC — Udhëzimet për AFP

Propozon metodologji pedagogjike që nxisin pjesëmarrjen aktive, aftësitë qytetare dhe ndërkulturore në kurrikul, duke ulur rrezikun e diskriminimit.

1 2 3 4

2010 — Deklarata e Strasburgut

Theksoi angazhimin për qasje të barabartë dhe jo-diskriminuese në të gjitha nivelet e arsimit dhe punësimit, duke kërkuar heqjen e barrierave strukturore.

2023 — CM/Rec(2023)4

Vendosi një dimension të ri: pjesëmarrjen aktive të të rinjve romë në vendimmarrje, duke i bërë ata bashkëhartues të politikave që prekin jetën e tyre.

⚠ Zbatimi praktik në Shqipëri ka hasur sfida të rëndësishme: hendek mes politikave të miratuara dhe zbatimit real, diskriminim dhe stigmatizim në shkolla profesionale, trajnim i kufizuar i mësuesve për menaxhimin e diversitetit kulturor.

Kuadri Ligjor Kombëtar

Kushtetuta Shqiptare (neni 57) garanton: *"Kushdo ka të drejtën për arsimim."* Ky parashikim, i interpretuar bashkë me nenin 18 për barazinë, njihet çdo personi pa asnjë kufizim. Megjithatë, situata reale pasqyron anën e kundërt.

Ligji nr. 69/2012

Për sistemin arsimor parauniversitar. Garanton arsim gjithëpërfshirës, ndalon diskriminimin, parashikon mësim në gjuhën amtare për pakicat kombëtare (neni 10).

Ligji nr. 18/2017

Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Neni 18 afirmon të drejtën për arsimim falas e cilësor; neni 33 garanton të drejtat kulturore dhe gjuhësore të pakicave.

Ligji nr. 15/2019

Për nxitjen e punësimit. Personat Romë dhe Egjiptianë cilësohen si grupe të veçanta dhe punëkërkues të disavantazhuar. Parashikon këshillim karriere dhe programe aktive të tregut të punës.

Ligji nr. 15/2017

Për arsimin dhe formimin profesional. Krijon sistem të njësuar AFP, parashikon transferim horizontal dhe vertikal, njohje të të nxënit joformal dhe informal.

Dokumentet Strategjike Kombëtare

VKM nr. 621/2021 — Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026

Synon një sistem arsimor cilësor bazuar në gjithëpërfshirje dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Parashikon bursa, orientim profesional dhe lidhje më të forta me tregun e punës.

Por realiteti tregon se bursat janë të pamjaftueshme, këshillimi profesional nuk njihet në çdo shkollë, dhe shumë programe VET ofrohen larg vendbanimeve të komuniteteve.

VKM nr. 701/2021 — Plani Kombëtar i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët 2021–2025

Hallkë lidhëse midis politikave arsimore dhe atyre të punësimit. Treguesit kryesorë deri në 2025:

- 80% më shumë fëmijë Romë dhe Egjiptianë përfundojnë arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm
- 60% e romëve dhe egjiptianëve punëkërkues të papunë të punësuar pas AFP-së
- 300 romë dhe egjiptianë më shumë të mbështetur financiarisht për sipërmarrje
- 70% e përfituesve të ndihmës ekonomike të riintegruar në punë

⚠ Sfidat e zbatimit: mungesa e koordinimit ndërinstitucional, burime të kufizuara financiare dhe kapacitete administrative të pamjaftueshme.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 24.3.2023 (i ndryshuar me VKM nr. 68/2025) përbën një hap kyç për të ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës të arsimit dhe punësimit për të rinjtë Romë dhe Egjiptianë.



AFP si Rrugë drejt Punësimit

Arsimi i mesëm dhe formimi profesional janë një nga rrugët më efektive për të krijuar një të ardhme më të mirë për të rinjtë Romë dhe Egjiptianë, duke i përgatitur për tregun e punës.



Këshillim dhe Orientim Karriere

Roli i këshillimit profesional është thelbësor për të informuar dhe udhëhequr të rinjtë dhe familjet e tyre drejt zgjedhjeve të duhura, duke marrë parasysh talentet dhe aspiratat personale.



Garancia Rinore

Të rinjtë nga Komunitetet Rome dhe Egjiptiane synohet të ndihmohen që brenda katër muajve nga përfundimi i arsimit të gjejnë punë, vazhdojnë studimet, ose përfshihen në trajnim profesional.




Qasje Integruese


Nuk mjafton thjesht të ofrohet arsim — të rinjtë duhet të ndihen të mbështetur dhe të motivuar gjatë gjithë rrugëtimit të tyre arsimor dhe profesional, me angazhim të komunitetit.

Analiza e Situata Aktuale — Të Dhënat e AKPA

Papunësia e Regjistruar — Komuniteti Rom



Papunësia e Regjistruar — Komuniteti Egjiptian



Të dhënat tregojnë që numri i personave të papunë është shumë më i lartë se numri i atyre të regjistruar si punëkërkues. **Rreth 45%** e punëkërkuesve të papunë nga Komuniteti Rom dhe **13.9%** nga Komuniteti Egjiptian nuk e kanë përfunduar arsimin fillor.

64%

Ulje nxënësish Romë

Në AP nga viti shkollor 2023-2024 në 2024-2025 — shifër alarmante

45%

Romë pa arsim fillor

E punëkërkuesve të papunë Romë të regjistruar në zyrat e punës

30

Të rinj në Garancinë Rinore

Nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane të përfshirë në këtë program


11.7%

Në Programet e Nxitjes

Pjesëmarrja e Romëve dhe Egjiptianëve në Programet e Nxitjes së Punësimit

Nxënësit në Arsimin Profesional dhe Konkluzionet

Nxënësit Romë dhe Egjiptianë në AP — 2024/2025



Numri i nxënësve Romë në AP u ul me **64%** — nga 251 në vetëm 91. Qarku i Korçës regjistroi uljen më të madhe. Profilet e preferuara mbeten Hoteleri-Turizëm, ndërsa profile digjitale (TIK, Programim, Zhvillim Website) kanë numër minimal ose zero nxënësish nga këto komunitete.

Konkluzione Kryesore

- Kuadri ligjor dhe institucional ekziston, por zbatimi praktik mbetet i dobët
- Mungesa e barazisë dhe diskriminimi janë ende realitet në shkolla dhe vende pune
- Komuniteti Rom dhe Egjiptian nuk është i informuar mirë për të drejtat dhe shërbimet
- Këshillimi i karrierës është praktikisht i munguar për këto komunitete
- Mungojnë të dhëna të sakta, periodike dhe të përditësuara për këtë target grup
- Braktisja e shkollës dhe segregimi mbeten sfida të pazgjidhura pavarësisht vendimeve të GjEDNj-së

Studimi rekomandon masa konkrete mbi kuadrin ligjor, informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, fuqizimin e prindërve dhe trajnimin e mësuesve për menaxhimin e diversitetit kulturor.

Analizë e Gjetjeve të Dala nga Pyetësorët

Në kuadër të këtij studimi u realizuan dy pyetësorë — njëri për nxënësit dhe njëri për prindër dhe nënpunës të administratës publike. Synimi ishte të kuptohej aksesi në edukimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional të nxënësve Romë dhe/ose Egjiptianë, të identifikoheshin sfidat e vazhdueshme dhe mundësitë për të nxitur reforma me synim rritjen e numrit të tyre.

MAJ 2025 | 98 NXËNËS | 108 PRINDËR & ADMINISTRATË

Pyetësori i Nxënësve: Profili i të Anketuarve

Ky pyetësor analizon përvojat arsimore të nxënësve nga Komunitetet Rom, Egjiptianë dhe mazhoranca në Shqipëri. Ai përmban 18 pyetje (15 të mbyllura dhe 3 të hapura) dhe u plotësua nga **98 persona** gjatë muajit Maj 2025. Rreth 90% e të anketuarve janë në moshë që duhet të ndjekin arsimin parauniversitar ose të lartë.

Përbërja gjinore

- 69,4% vajza
- 29,6% djem
- 1% preferuan të mos përgjigjen

Përkatësia komunitare


- 51% Komuniteti Rom
- 40,8% Komuniteti Egjiptian
- ~10% mazhoranca

Shpërndarja sipas moshës

- 48% mosha 18–20 vjeç
- 42% mosha 14–18 vjeç
- ~7% mbi 20 vjeç
- Pjesa tjetër nën 14 vjeç

Shpërndarja Gjeografike dhe Lloji i Arsimit

Pyetësori u shpërnda elektronikisht për të përfshirë të gjithë territorin e Shqipërisë. Sipas përgjigjeve, **36,5%** e nxënësve janë nga Tirana, 14,6% nga Elbasani, Fieri, Shkodra etj. Si kryeqytet, Tirana ofron më shumë shkolla, por nxënësit nga komunitetet romë dhe egjiptiane përballen me ndjesi të theksuar përjashtimi dhe diskriminim të hapur.



⚠ Ndonëse në nivele 5,1%, nxënësit që "konsiderohen jashtë sistemit" përbëjnë grupin më shqetësues — jashtë edukimit formal, në rrezik të lartë për përjashtim të plotë social dhe ekonomik në të ardhmen.

Frekuentimi, Qëndrueshmëria dhe Diskriminimi

Frekuentimi i shkollës

79,6% ndjekin shkollën çdo ditë, 16,3% disa ditë në javë dhe rreth 5% e kanë lënë atë. Ndjekja me ndërprerje sjell pasoja të rënda për cilësinë e mësimit dhe është hapi i parë drejt braktisjes.

Kam lënë ndonjëherë shkollën?

83,7% — JO | 16,3% — PO

18 persona listuan arsyet: faktorë ekonomikë, pengesa familjare, emigracion dhe probleme shëndetësore.

Diskriminimi në shkollë

70% e të anketuarve kanë ndjerë diskriminim për shkak të përkatësisë së tyre. Duke vlerësuar se ~10% i përkasin mazhorancës, kjo tregon se nga pjesa tjetër vetëm 20% nuk kanë ndjerë diskriminim.

Format përfshijnë: veçim në klasë, etiketime ofenduese nga mësuesit apo shokët dhe stereotipe të përsëritura. Kjo çon në një rreth vicioz: më pak pjesëmarrje, më pak përkrahje, më shumë braktisje.

Mbështetja, Pengesat dhe Planet për të Ardhmen

Çfarë mbështetjeje merrni?

- **~50%** — libra/materiale mësimore falas
- **~40%** — ndihmë financiare ose bursë
- **15%** — mbështetje në mësime
- **9%** — ndërmjetës rom/kulturor

Vetëm 22,4% marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore. **54%** renditin problemet ekonomike si pengesën kryesore.

Planet pas mbarimit të shkollës

- **52%** — duan të vazhdojnë arsimin e lartë
- **16,3%** — duan të fillojnë punë
- **12,3%** — duan të ndjekin AFP ose trajnim profesional

Këshillim karriere?

Vetëm **38,8%** kanë marrë këshillim karriere, ndërsa **61,2%** nuk e dinë çfarë është ky shërbim — pothuajse inekzistent në shkolla.

Sugjerimet e nxënësve për një mjedis më të mirë: respekt dhe mosdiskriminim, prani mentorësh nga komuniteti, mbështetje akademike e strukturuar, transport falas, vakt ushqimor dhe gjithëpërfshirje kulturore.

Pyetësori i Prindërve dhe Administratës Publike

Ky pyetësor analizon përvojat arsimore nga këndvështrimi i prindërve dhe nënpunësve të administratës publike. Përmban 14 pyetje dhe u plotësua nga **108 persona**: 66,7% prindër, 11,1% mësues/psikologë, 8,3% nënpunës të administratës publike. 71,3% janë gra/vajza, 45,4% nga Komuniteti Egjiptian dhe 31,5% nga Komuniteti Rom.

Shpërndarja gjeografike

33,6% nga Tirana, 21,5% nga Elbasani, 9,3% nga Durrësi dhe pjesa tjetër të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë.


Mosha e të anketuarve

69% janë të moshës 30–50 vjeç — mosha më e përshtatshme për prindër, mësues dhe nënpunës të administratës.

Perceptimi i përfshirjes

Vetëm 26% e vlerësojnë përfshirjen si të mirë; 44% e konsiderojnë të dobët ose shumë të dobët në zonën e tyre.

Gjetjet Kryesore: Përgatitja e Shkollave dhe Programet Aktive



Vetëm **18,5%** mendojnë se shkollat janë plotësisht të përgatitura për të përfshirë dhe mbështetur nxënës romë dhe egjiptianë. **58,3%** raportojnë se nuk ka programe aktive mbështetëse në zonën e tyre, dhe **57,4%** konfirmojnë se këshillimi i karrierës mungon ose ofrohet shumë rrallë. Këto rezultate tregojnë një hendek të madh midis objektivave strategjike dhe zbatimit real në terren.

Kuadri Ligjor dhe Mungesa e Barazisë

Kuadri ligjor — gjetjet

- Kuadri ligjor është harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i fragmentuar dhe shpesh joefektiv
- VKM nr. 701/2021 përfaqëson një shtyllë thelbësore, por ndikimi real mbetet i kufizuar
- Mungon monitorimi sistematik dhe të dhëna të sakta mbi efektivitetin e masave
- Strukturat shtetërore perceptohen si entitete formale, pa prani aktive me komunitetin

Diskriminimi dhe pabarazia

- Diskriminimi i përditshëm në mjedisin shkollor: përjashtim nga aktivitetet, trajtim i pabarabartë nga mësuesit
- Mungesa e këshillimit profesional kufizon orientimin në rrugët e arsimit dhe punësimit
- Vetëm 17,6% e konsiderojnë kuadrin ligjor si mbështetës dhe efektiv
- Masat aktuale nuk adresojnë plotësisht barrierat praktike: transport, kosto, presion ekonomik

Rekomandime

1

Kuadri ligjor dhe politikat publike

Financim i qëndrueshëm për masat specifike; thjeshtim i procedurave për bursa dhe transport; sistem transparent monitorimi me indikatorë të matshëm për regjistrim, vijueshmëri dhe punësim pas AFP.

2

Këshillimi i karrierës dhe të dhënat

Këshillim i detyrueshëm në çdo shkollë 9-vjeçare dhe të mesme; krijim i database-s së integruar për gjurmimin nga regjistrimi deri te punësimi; raporte periodike monitorimi.

3

Informimi dhe fuqizimi i komunitetit

Ekipet e terrenit me ndërmjetës romë/mediatorë kulturorë; mentorë nga komuniteti si shembuj frymëzues; fushata informimi në gjuhë të thjeshtë; kurse të gjuhës dhe kulturës rome në shkolla.

4

Prindërit dhe mësuesit

Ndërgjegjësim i prindërve për rolin e arsimit; takime dhe punëtori komunitare; module trajnimi për mësuesit mbi mosdiskriminim, diversitet kulturor dhe metodologji përfshirëse.

Bibliografia dhe Aneksët

Akte ligjore kryesore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar"
- Ligji nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional"
- Ligji nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare"
- VKM nr. 621/2021 — Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026
- VKM nr. 701/2021 — Plani Kombëtar për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje

Dokumente ndërkombëtare

- Council of Europe — Recommendation Rec(2000)4 dhe CM/Rec(2009)4
- Strasbourg Declaration on Roma, 2010
- Convention against Discrimination in Education (UNESCO)
- ILO Convention No. 142
- Raport Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2020
- Studim fizibiliteti "Shkolla Naim Frashëri, Korçë", CoE, 2024

Aneksë

Tre kërkesa zyrtare për informacion drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

Studimi u realizua nga Prof. Asoc. Dr. Ersida Teliti në bashkëpunim me organizatën Roma Versitas Albania, Maj 2025.